



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Biznes dhe ekonomiks (LSE)**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Titulli	I diplomuar në biznes dhe ekonomiks
Numri në arkiv i akreditimit [180]	17-893/1
Vendimi për fillim me punë	03-3237/2 (10.11.2017)
Data akreditimit	01.04.2016

Përshkrimi i programit

Programi studimor “**Biznes dhe ekonomiks**” paraqet kombinim të barazpeshuar të njohurive bazë teorike dhe shkathtësive specifike profesionale. Struktura e programit trevjeçar përfshin studime të cilat nga natyra janë dinamike dhe interaktive. Programi është dizajnuar të ofrojë tema nga lëmi i ekonomisë dhe menaxhmentit, duke bërë implementimin e konceptit në fjalë përmes programit studimor. Lëndët të cilat janë të përfaqësuara në këtë program paraqesin perspektiva të cilat bazohen mbi teorinë e cila është ngushtë e lidhur me implementimin praktik në botën e biznesit. Ky program u mundëson studentëve përvetësim të aftësive dhe përvojave të nevojshme për: teorinë ekonomike, përdorimin e menaxhmentit, financave si dhe analizë ekonometrike të të dhënave.

Programi studimor “**Biznes dhe ekonomiks**” ka për qëllim:

- T'i përgatisë studentët për pozita të liderëve në organizata profitabile apo joprofitabile në vend dhe çdo kund në botë.
- T'i përgatisë studentët për ndërtim të karrierës në lëmin e ekonomisë dhe menaxhmentit, por edhe të sektorit privat në lëmin e financave.
- Të mundësojë përvetësim të aftësive dhe përvoja hulumtuese për: teorinë ekonomike, përdorim të menaxhmentit, financave si dhe analizë ekonometrike të të dhënave.
- Ta zhvillojë konceptin e punës praktike tek studentët.
- Ta zhvillojë konceptin e të menduarit kritik tek studentët.
- T'u mundësojë studentëve në mënyrë aktive të kyçen në ligjëratat me qëllim që në mënyrë të pavarur t'i kryejnë hulumtimet në të gjitha fushat e ekonomisë dhe menaxhmentit.
- Të mundësojë zhvillim të aftësive personale, komunikuese, hulumtuese dhe aftësive të tjera që janë të rëndësishme për punësim.

Gjatë kohës së studimeve trevjeçare, studentëve u jepen mundësi për punëpraktike (internship), me çka ata do të aftësohen t'i implementojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë lëmi.

Programi studimor “**Biznes dhe ekonomiks**” jep mundësi për diplomë të dyfishtë (Double Degree) në bashkëpunim me Universitetin e Londrës (UoL) – London School of Economics (LSE). Përmbajtja kryesore e programit përfshin lëndë të cilat ofrohen edhe nga ana e universitetit britanik – LSE. Lëndët e programit janë kompatible me programin mësimor të LSE-së. LSE gjithashtu siguron mbështetje për realizim të programit përmes ofrimit të literaturës, lëndëve programore, planeve mësimore, provimeve dhe shembuj të video ligjëratave.

Për informata të detajuara në lidhje me procedurën e aplikimit, ju lutemi vizitoni: [Diplomë e dyfishtë](#)

Karriera

Programi studimor “**Biznes dhe ekonomiks**” do t’u mundësojë studentëve të:

- Fitojnë njohësim të përgjithshëm në disiplina qënëvizojnë teorinë dhe praktikën e menaxhmentit ndërsa nga ana tjetër ende ngelen të specializuarit në ekonomi;
- Ndërmarrin studim të thelluar të ekonomisë me opsionet e menaxhmentit që do t’u mundësojë të shikohen në mënyrë kritike çështjet e menaxhmentit;
- Fitojnë trajnim në parimet e ekonomisë dhe aplikimeve të tyre;
- Zhvillojnë të kuptuarit se menaxhmenti është një shkencë bazë të gjërës sociale dhe fushë multidisiplinare;
- Njihen me mjetet e përshtatshme të analizës për të trajtuar çështje dhe problematika të politikave ekonomike;
- T’i kuptojnë organizatat, aspektet kyçe të menaxhimit të tyre dhe ambientin e jashtëm në të cilin ato operojnë;
- Kenë njohësim të mirë të komunikimit interpersonal dhe komunikativ;
- Kenë një bazë të fortë për studime të mëtejshme dhe për punësim;

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të nevojshme për funksionet biznesore si në vijim: ekonomi, menaxhment, financa, biznes dhe menaxhment në kontekstin global, parimet e kontabilitetit, financat e korporatave, menaxhimin strategjik, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe marketing;
- Ka njohuri të fushave funksionale të ekonomisë dhe menaxhmentit, hulumtimet dhe inovacionet aktuale, trendet e ardhshme si dhe ndikimin e këtyre ndodhjeve në teori dhe praktikë.
- Ka njohuri dhe të kuptuarit e situatës kombëtare, rajonale dhe globale ekonomike në treg;
- Ka njohuri të teorive menaxheriale, analizave dhe raportimeve;
- Të fitojnë bazë të fortë për atë që si të zhvillohet mëshpejt ekonomia dhe të jetë i gatshëm për karrierë dhe studime postdiplomike që kanë të bëjnë me ekonominë dhe menaxhmentin, ose me drejtime tjera të përafërta;
- Ka njohuri për mjetet e ndryshme të nevojshme për marrjen e vendimeve menaxheriale;

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për të shkruar në mënyrë profesionale dhe zhvillim të mëtutjeshëm të detyrave në ekonomi dhe menaxhment dhe implementimi i tyre në jetën reale;
- Aftësi për të ndihmuar në formulimin dhe zbatimin praktik të planeve të suksesshme të menaxhimit të përgjithshëm dhe strategjive;

Aftësitë për të vlerësuar

- Të mendojnë në mënyrë kritike dhe t’i aplikojnë dijet teorike dhe praktike dhe eksperiencën për identifikimin dhe analizën e problemeve ekonomike;
- Të analizojnë në mënyrë kritike dhe ta vlerësojnë identifikimin e mundësive menaxheriale;

Aftësitë e komunikimit

- Ta tregojnë të kuptuarit e dinamikës individuale dhe grupore;
- Të funksionojnë në mënyrë efektive në punën ekipore;
- Të merren në mënyrë efektive me njerëz që kanë prejardhje të ndryshme në aspektin shoqëror, ekonomik, kulturor dhe fetar;
- Të demonstrojnë mirëkuptim dhe ndjeshmëri për përgjegjësitë etike, sociale dhe ligjore të kompanive;
- Të shfaqin idetë e biznesit në mënyrë efektive;
- Të demonstrojnë aftësi kyçe negociuese;
- Të interpretojnë të dhënat e biznesit dhe treguesit ekonomikë;

Aftësitë e të mësuarit

- Mund të hulumtojnë dhe të dektektojnë burimet e të mësuarit;

- Mund të trajnohen për mësim individual dhe ekipor;
- Kanë aftësinë për të përdorur literaturë shkencore dhe analizat e opinionëve dhe vlerësimeve të autorëve të tjerë;

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [6.0 SETK] **Hyrje në biznes dhe menaxhment**
- [6.0 SETK] **Bazat e matematikës**
- [6.0 SETK] **Hyrje në ekonomi**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndët zgjedhore të lira**

Semestri 2

- [6.0 SETK] **Parimet e kontabilitetit**
- [6.0 SETK] **Mikroekonomia**
- [6.0 SETK] **Bazat e statistikës**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndët zgjedhore të lira**

Semestri 3

- [6.0 SETK] **Makroekonomia**
- [6.0 SETK] **Konceptet bazike të menaxhmentit**
- [6.0 SETK] **Kontabiliteti financiar**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndët zgjedhore të lira**

Semestri 4

- [6.0 SETK] **Parimet e bankierisë dhe financave**
- [6.0 SETK] **Menaxhimi i burimeve nejrëzore**
- [6.0 SETK] **Bazat e ekonometrisë**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndët e përgjithshme zgjedhore**

Semestri 5

- [6.0 SETK] **Financat e korporatës**
- [6.0 SETK] **Ekonomia monetare**
- [6.0 SETK] **Parimet e marketingut**
- [6.0 SETK] **Lëndët e përgjithshme zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 6

- [6.0 SETK] **Biznes - Modelime me Excel**
- [6.0 SETK] **Financat publike**
- [6.0 SETK] **Ekonomia e punës**
- [6.0 SETK] **Lëndët e përgjithshme zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Hyrje në biznes dhe menaxhment**

Synimi i lëndës është futja e studentit në botën e menaxhmentit në veçanti dhe biznesit në përgjithësi. Në mes tjerash kjo lëndë përfshin funksionet bazë të menaxhmentit, si: planifikimi, organizimi, udhëheqja dhe kontrolli. Krahas kësaj studentët do të njohohen dhe me tema më specifike siç janë: delegimi i autoritetit, përpilimi i strukturave organizative, krijimi dhe implementimi i politikave organizative, organizimi i procesit të prodhimit, cilësia, kontrolli i shpenzimeve etj. Pas përfundimit të lëndës, studentët do t'i realizojnë përfitimet në vijim: - Studentët do të aftësohen që në situata pune ta identifikojnë punën e menaxherit në përputhshmëri me aktivitetet kyçe që përfshihen me procesin e menaxhmentit si dhe funksionet e zbatuara menaxheriale dhe ekzekutive. - Studentët do të aftësohen të zbatojnë analiza të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të biznesit, përfshirë këtu edhe kulturën organizative si dhe sfidat që dalin nga funksionimi në mjedis ndërkombëtar, multinacional dhe global. - Studentët do të aftësohen që në situata specifike të zbatojnë analiza përkatëse si dhe të ofrojnë propozime në drejtim të ndërmarrjes së aktiviteteve me të cilat do të promovohet sjellje etike. - Studentët do të aftësohen të bëjnë vlerësim të planeve afariste dhe të ofrojnë alternativa për përmirësimin e tyre në drejtim të zmadhimit të efektivitetit të planifikimit dhe vendimmarrjes. - Studentët do të aftësohen që në suaza të skemave organizative ta bëjnë identifikimin e elementeve funksionale të organizatës dhe në këtë mënyrë të ofrojnë alternativa për përmirësim të dizajnit organizativ. - Studentët do të aftësohen që në varësi nga nevoja e identifikuar për burimet njerëzore të krijojnë një sistem funksional të rekrutimit dhe seleksionimit që do të rezultojë me një ekipim përkatës të organizatës së biznesit. - Studentët do të aftësohen që nga pozita e liderit të rekomandojnë aktivitete që do të nënkuptonin hapa konkretë për motivim përmes lidershit në drejtim të modifikimit të sjelljes së të punësuarve. - Studentët do të aftësohen të ofrojnë mendime alternative për përmirësim të procesit të komunikimit të organizatave të biznesit duke përfshirë edhe disa aspekte specifike siç janë menaxhimi i relacioneve ndërpersonale, grupet e punës dhe ekipet. - Studentët do të aftësohen që sipas nevojës të përpilojnë plane që do t'i kishin përfshirë aspektet kyçe të kontrollit menaxherial siç janë: menaxhimi me informata, operacione, cilësi dhe produktivitet. Marrë në përgjithësi, kjo lëndë përfshin qëllimet vijuese të përgjithshme: - Përfitim i diturisë (terminologji, klasifikime, trende) - Mësim i teorive ose parimeve themelore. - Mësim se si të zbatohen dituritë e përfituara (për të përmirësuar procesin e të menduarit, aftësia për të zgjidhur probleme dhe për të sjellë vendime) - Zhvillim i shkathtësive të veçanta, kompetencave dhe qasjeve në të menduar për situata dhe probleme. - Përfitim i aftësisë për bashkëpunim me të tjerët si pjesë e grupeve punuese ose ekipeve. - Nxitje e kreativitetit. - Zhvillim i aftësisë për të shprehur në mënyrë gojore dhe të shkruar mendimet dhe qëndrimet - Mësim se si të gjenden dhe të shfrytëzohen burime përkatëse për zgjedhje dhe tejkalim të problemeve. - Krijim i një kuptimi më të qartë për konceptin e vlerave personale si dhe zhvillimin e tyre. - Aftësim për analizë kritike të ideve, argumenteve dhe mendimeve - Nxitje për t'u kyçur në debate dhe për të hapur tema diskutimi.

• Bazat e matematikës

Qëllimi i programit të lëndës: Qëllimi është që studentët të marrin njohuri themelore në lëmin e kalkulusit dhe të algjibrës lineare që ato t'i zbatojnë në lëmenjtë tjerë si dhe në fushat e ndryshme në sferën e ekonomisë. Në mes tjerash qëllimi është që studentët të njihen dhe të aftësohen me kuptimet: funksionin (si një pasqyrim I veçantë), me mënyrat e dhënies së një funksioni, vetitë e funksionit, gjetjen e derivatit të funksionit, zgjidhjen e problemeve në lidhje me vizatimin e grafikut të funksionit prej nga mund të lexohen të gjitha vetitë dhe karakteristikat e funksioneve të cilët mund të zbatohen në lëmin e ekonomisë. Po ashtu ka për qëllim që studentët të njihen me konceptin e integralit dhe të njëjtin ta zbatojnë në probleme të ndryshme praktike. Qëllimi tjetër është zgjidhja dhe zbatimi I problemeve nga fusha e algjibrës lineare.

• Hyrje në ekonomi

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ta zhvillojë kuptimin bazik të koncepteve dhe teorive kryesore ekonomike, të cilat përdoren për analizë të çështjeve ekonomike. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë formë që t'u mundësojë studentëve të pajisen me njohuri për parimet bazë, me konceptet dhe teknikat në fushën e ekonomisë si shkencë si dhe në analizat ekonomike. Kjo lëndë siguron hulumtimin e parimeve të mikroekonomisë dhe makroekonomisë, duke u fokusuar në implementimin e dijes në sjelljen e vendimeve në një ambient global. Pas mbarimit të lëndës, studentët duhet të aftësohen të: përdorin modelin e ofertës dhe kërkesës dhe të përcaktojnë ndikimin e ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës mbi çmimin dhe sasinë; të definojnë PBB (GDP) dhe të kalkulojnë matjen, përdorimin dhe kufizimin e PBB (GDP) si mjet të mirëqenies ekonomike; të definojnë inflacionin dhe ta kalkulojnë atë, të njihen me pasojat dhe si të përshatën në to; si dhe të përshkruajnë rolet dhe mjetet e bankës qendrore.

• Parimet e kontabilitetit

Qëllimi i lëndës është t'i ndihmojë studentët ta kuptojnë esencën e kontabilitetit; t'i mësojnë bazat e kontabilitetit, konceptet dhe parimet e kontabilitetit. Me theks të veçantë, studentët do të marrin njohuri dhe do t'i kuptojnë pasqyrat financiare, komponentët e tyre, rregullat bazë të regjistrimit të të dhënave kontabël si dhe do të dinë ta përdorin dokumentacionin kontabël.

• Mikroekonomia

Qëllimet e lëndës janë: • Thëllimi i kuptimit të teorive bazike të optimizimit nga agjentët ekonomikë dhe efikasitetit të rezultatit përfundimtar për tregun si tërësi; • T'i njoftojë studentët me analizën e ndërveprimit strategjik si dhe të ndërveprimit nën informacionit asimetrik; • Ta qartësojë rolin e politikave ekonomike si mjete për përmirësimin e efikasitetit nën prezencën e dështimeve të tregut (market failure); • Ta nxisë aftësinë e të menduarit në një kornizë të strukturuar dhe ta qartësojë rëndësinë e argumenteve formale; • Ta demonstroj artin e modelimit që kërkon thjeshtësimin e problemit duke identifikuar elementet kryesore, pa thjeshtësuar çështjen.

• Bazat e statistikës

Qëllimi i lëndës është në aplikimin e metodave statistikore në menaxhmentin e ekonomisë dhe në shkencat shoqërore. Vëmendja do të përqendrohet në interpretimin e tabelave dhe rezultateve dhe mënyrën më të përshtatshme për qasjen e problemeve statistikore. Trajtimi është në një nivel elementar matematikor. Iidetë e probabilitetit, konkluzionet dhe analizat mund t'i gjejnë më tej në lëndën Statistikë2.

• Makroekonomia

Lënda ka për qëllim t'i krijojë dijet bazike dhe të thellojë ato nga fusha e makroekonomisë. Në të përfshihen analizat e gjendjeve dhe draftimi i masave për optimizimin e ekonomisë nacionale në tërësi. Një vështrim i veçantë do të fokusohet në caqet që studentët praktikisht t'i kuptojnë gjendjet ekonomike dhe të munden t'i kuptojnë metodat e dizajnit dhe miratimit të politikave makroekonomike në nivel të ekonomisë nacionale. Aspekti i menaxhimit të politikave makroekonomike si ato të llojeve të IS-LM deri në zbatimin praktik të tyre. Faktorët makroekonomikë si bartës të një ekonomie nacionale me vështrim të veçantë në ekonominë e Maqedonisë. T'i trajtojë të gjitha këto aspekte si nga aspekti i ekonomisë së kërkesës dhe ofertës gjithashtu.

• Konceptet bazike të menaxhmentit

Qëllimi i kësaj lënde është që të japë një hyrje për bazat e menaxhmentit dhe definimin e tij, në konceptet bazike të menaxhmentit për çdo menaxher. Mësimi i kësaj lënde synon gjithashtu që t'ju ofroj studentëve kuptimin e funksionit themelor të menaxhmentit, duke përfshirë, planifikimin, personelin, oragnizimin, dhe kontrollin. Pas përfundimit të kësaj lënde, studentet duhet të jenë në gjendje që: - Duke pasur parasysh një përshkrim për një ndërmarrje specifike biznesore, ta bëjë një përshkrim të punës menaxheriale, që përfshin aktivitetet themelore të procesit të menaxhmentit dhe punës së menaxherit; - Duke pasur parasysh një rast, ku do ta përshkruajë situatën në mjedisin e jashtëm, të shkruajë një raport për analizën e mjedisit biznesor të jashtëm dhe të brendshëm, duke përfshirë kulturën organizative dhe sfidat e veprimit në një mjedis ndërkombëtar, multikulturor dhe global; - Duke pasur parasysh një situatë specifike etike, ta analizojë situatën dhe të përgatisë rekomandime për lëndën ku do të nxitet sjella etike; - Duke pasur parasysh një shembull të një plani të biznesit, ta vlerësojë planin dhe të japë rekomandime se si plani do ta përmirësojë planifikimin efektiv gjatë vendimmarrjes; - Duke pasur parasysh një strukturë organizative të propozuar, t'i identifikojë elementet funksionale të organizatës, ta krijojë një dizajn organizativ dhe t'i ofrojë rekomandimet për ndryshimin organizativ; - Duke pasur parasysh një skenar të udhëheqjes, të rekomandojë një kurs veprimi që përfshin konceptet e motivimit dhe udhëheqjes për të influencuar në sjelljen; - Duke pasur parasysh një situatë që bën thirrje për përmirësimin e marrëdhënieve ndërpersonale brenda një organizate, të krijojë një plan të veprimit që trajton procesin e komunikimit, si dhe çështjet dhe metodat e menaxhimit të marrëdhënieve ndërpersonale të individëve, grupeve të punës dhe ekipeve; - Duke pasur parasysh një situatë që kërkon nevojën për të rregulluar veprimtaritë organizative, studentët do të krijojnë një plan të menaxhimit që përfshin elementet bazë të kontrollit në organizatat dhe që specifikon se si ta menaxhojnë informatën, operacionet, cilësinë, produktivitetin.

• Kontabiliteti financiar

Qëllimet e programit të lëndës: Procesi i regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të një morie të transaksioneve nga një biznes, në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë e saktë e pozicionit të saj financiar dhe të performancës. Objektivi kryesor i kontabilitetit financiar është përgatitja e pasqyrave financiare: bilanci i gjendjes, pasqyra e të ardhurave dhe rrjedha e parave me çka bëhet publike performanca operative e kompanisë gjatë një periudhe të caktuar dhe pozita financiare në një datë të caktuar kohore. Këto pasqyra - të cilat janë përgatitur në periudha kohore kuartale dhe vjetore dhe që janë në përputhje me SNK u dedikohen palëve të jashtme, duke përfshirë investitorët, kreditorët, rregullatorët dhe autoritetet tatimore.

• Parimet e bankierisë dhe financave

Qëllimi i lëndës: - të mundësojë diskutim për sistemet financiare, pse ekzistojnë ato dhe si janë të strukturuar; - të shpjegojë pse rëndësia relative e ndërmjetësve financiarë dhe tregjeve financiare është e ndryshme në vende të ndryshme të botës dhe si sistemet e bazuara në banka dallojnë nga sistemet e bazuara në treg; - të mundësojë të kuptohet se pse ekzistojnë ndërmjetësuesit financiarë dhe të diskutohet për rolin e kostove të transaksionit dhe teorive mbi informacionet asimetrike në sigurimin e një justifikimi ekonomik; - të shpjegojë pse bankat kanë nevojë

për rregullim, t'i ilustrojë arsyet kryesore për dhe kundër rregullimit të sistemit bankar; - të mundësojë diskutim rreth llojeve kryesore të risqeve me të cilat përballen bankat dhe t'i përdorin teknikat kryesore të përdorura nga bankat për të menaxhuar me risqet; - të shpjegojë se si të vlerësohen aktivet reale dhe ato financiare dhe të mund të përdorin teknikat kryesore të buxhetimit të kapitalit (Neto vlera aktuale Norma e brendshme e kthimit); - të shpjegojë se si të vlerësohen aktivet financiare (obligacionet dhe aksionet); - të mundësojë të kuptohet se si risku ndikon në kthimin e aktiviteve me risk si dhe si risku ndikon në vlerën e aktiveve në ekuilibër në bazë të paradigmave të çmimeve të aktiveve themelore (Modeli i çmimit të aktiveve të kapitalit dhe teoria e çmimeve të aktiveve); - të mundësojë diskutim nëse çmimet e aksioneve i reflektojnë të gjitha informatat në dispozicion dhe të vlerësojë evidencën empirike mbi efikasitetin e informatave në tregjet financiare.

• **Menaxhimi i burimeve nejrëzore**

Kjo lëndë ka për synim t'i pajisë studentët me njohuri të mjaftueshme rreth konceptioneve klasike të menaxhimit të burimeve njerëzore, por njëkohësisht edhe me njohuri bazike rreth aspekteve më bashkëkohore të menaxhimit të burimeve njerëzore. Lënda "Menaxhimi i burimeve njerëzore" në nivelin e studimeve deridiplomike ka qëllimet në vijim: - Të pajisen studentët me njohuri bazë rreth koncepteve kyçe të menaxhimit të burimeve njerëzore; - Studentët të krijojnë një qëndrim personal mbi rolin dhe rëndësinë e punëtorit si individ për sigurimin e mbijetesës së organizatave të biznesit në botën bashkëkohore të globalizimit dhe zhvillimit të gjithanshëm teknik dhe teknologjik; - Studentët të ndërtojnë një qëndrim personal mbi rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore për sigurimin e mbijetesës së organizatave bashkëkohore të biznesit; - Studentët të pajisen me informata dhe dituri të mjaftueshme mbi aktivitetet bazë të menaxhimit të burimeve njerëzore duke filluar nga dizajni i vendeve të punës dhe analiza e punës, përmes rekrutimit dhe seleksionimit e deri te zhvillimi dhe largimi nga puna e punonjësve; Marrë në përgjithësi, kjo lëndë përfshin qëllimet vijuese të përgjithshme: - Përfitim i ditorisë (terminologji, klasifikime, trende); - Mësim i teorive ose parimeve bazë; - Mësim se si të zbatohen ditoritë e përfituara (për t'u përmirësuar procesi i të menduarit, aftësia për të zgjedhur probleme dhe për të sjellë vendime) - Zhvillim i shkathtësive të veçanta, kompetencave dhe qasjeve në të menduar për situata dhe probleme.; - Përfitim i aftësisë për bashkëpunim me të tjerët si pjesë e grupeve punuese ose ekipeve. - Nxitje e kreativitetit; - Zhvillim i aftësisë për të shprehur në mënyrë gojore dhe të shkruar mendimet dhe qëndrimet; - Mësim se si të gjenden dhe shfrytëzohen resurse përkatëse për zgjedhje dhe tejkalim të problemeve; - Krijim i një kuptimi më të qartë për konceptin e vlerave personal si dhe zhvillim të të njëjtave; - Aftësim për analizë kritike të ideve, argumenteve dhe mendimeve; - Nxitje për t'u kyçur në debate dhe për të hapur tema diskutimi;

• **Bazat e ekonometrisë**

Qëllimet e programit të lëndës: - Të zhvillohet një kuptim për përdorimin e analizës së regresionit dhe teknikave përkatëse për përcaktimin sasior të marrëdhënieve ekonomike dhe testimin e teorive ekonomike; - T'i aftësojë studentët t'i lexojnë dhe t'i vlerësojnë studimet empirike në revista profesionale; - T'i pajisë studentët me përvojë praktike të përdorimit të programeve të zakonshme të regresionit që përshtaten me modelet ekonomike;

• **Financat e korporatës**

Qëllimi i lëndës është transferimi i shkathtësive dhe njohurive të nevojshme teorike në fushën e menaxhimit financiar, si dhe përgatitja e studentëve me njohuri dhe me përvojë bashkëkohore teorike në analizën e koncepteve themelore të financave korporative, projekteve investuese financiare e reale dhe vlerësimi i tyre përmes dimensionit kohor të parave. Qëllimi i lëndës vazhdon me trajnimin e studentëve se si të përdorin burime adekuate të financimit, si ta bëjnë menaxhimin efikas të kapitalit dhe si ta bëjnë përcaktimin e strukturës adekuate, përcaktimin e politikës adekuate të shpërndarjes së fitimit - politikës së dividendit dhe si të bëhet finalizimi i planifikimit financiar dhe parashikimi, etj. Arritja e objektivave të synuara të lëndës, studentëve u krijon mundësi të reja për qasje më konkurruese në tregun e punës ose menaxhim më efikas të bizneseve të tyre reale.

• **Ekonomia monetare**

Qëllimet e lëndës janë: • ta zhvillojë të kuptuarit e teorive që ndërlidhen me ekzistimin e parasë, të shpjegojë pse ajo kërkohet nga individët dhe për përdorimin në tregti; • ta zhvillojë të kuptuarit e mekanizimit të transmetimit monetar, ku vendimet e marra nga autoritetet monetare në lidhje me ofertën e parasë ose normat e interesit mund të ketë efekte reale në ekonomi; • të zhvillojë një numër të caktuar të modeleve makroekonomike përmes së cilës politika monetare mund të vlerësohet. Këto modele do të përfshijnë si mendimet e shkollës klasike ashtu edhe atë Kejnside dhe do të konsiderojë se pse çështjet e politikës monetare kanë rëndësi dhe kur vendimet e politikës monetare mund të jetë impotente; • ta zhvillojë të kuptuarit e pasigurive me të cilat ballafaqohen politikëbërësit dhe se si politikëbërësit mund t'i menaxhojnë me këto.

• **Parimet e marketingut**

Kjo lëndë u ofron studentëve një pasqyrë të funksioneve të marketingut me theks të veçantë në krijimin e vlerës

përmes marketingut, kërkimeve të marketingut, sjelljes së konsumatorëve, strategjive të çmimeve, kanaleve të shpërndarjes dhe metodave të ndryshme të promovimit. Studentët do të mund të: - kuptojnë rolin e marketingut brenda shoqërisë dhe brenda sistemit ekonomik; - mësojnë rolin jetik të marketingut brenda ndërmarrjes dhe marrëdhëniet e nevojshme mes marketingut dhe fushave të tjera funksionale të biznesit; - kenë në konsideratë fushat e ndryshme vendimmarrëse brenda marketingut dhe metodat e përdorura nga menaxherët e marketingut për marrjen e vendimeve; - mësojnë parimet kryesore të marketingut si dhe terminologjinë dhe konceptet; - vlerësojnë se si një perspektivë e marketingut është e rëndësishme në zhvillimin e tyre personal dhe profesional;

- **Biznes - Modelime me Excel**

Qëllimet e programit të lëndës : - Të kuptojnë se si ndërmarrjet krijojnë vlerë duke aplikuar të menduarit e modelit të biznesit; - Përdorimi i funksioneve excel për modelin e biznesit; - Aplikimi i Excel-it në sfera të ndryshme të biznesit përmes modelimit;

- **Financat publike**

Qëllimet e programit të lëndës: Studentët të aftësohen me kuptimet bazike të koncepteve dhe parimeve të financave publike si dhe t'i mësojnë instrumentet fundamentale të financave publike dhe mënyrën e zbatimit të tyre në nivel të një ekonomie nacionale; Përmbajtjet bazike të financave publike duke filluar nga aspektet normative dhe pozitive të financave publike, krijimi i caqeve bazike dhe realizimi i tyre përmes të ardhurave publike, shpenzimeve publike, diferencave buxhetore (suficit/deficit) dhe menaxhimi me huatë publike; Posaçërisht studentët të përgatiten me dije të mjaftueshme rreth metodave të vlerësimit dhe matjes së shpenzimeve publike për projekte dhe përcaktimin e prioriteteve për financimin e tyre me burime nga të ardhurat publike. Përfundimisht decentralizimi fiskal dhe financat publike të BE-së përfshi edhe trendet e tyre.

- **Ekonomia e punës**

Qëllimet e lëndës studimore: Studentët të jenë të aftë: - Ta kuptojnë procesin e tregut në përcaktimin e pagës përmes ndërveprimit të ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore; - Ta analizojnë ndikimin e tregut të punës, papërsosshmërinë dhe politikat e ndryshme qeveritare mbi pagat dhe motivimin për punë; - T'i kuptojnë dhe t'i vlerësojnë implikimet e ndryshme të institucioneve të ndryshme politike dhe ekonomike mbi pagat dhe punësimin; - Ta analizojnë dhe ta bëjnë dallimin mes strukturave të tregut të punës; - Ta kuptojnë papunësinë, llojet e ndryshme të papunësisë dhe politikat për zvogëlimin e saj; - T'i analizojnë marrëdhëniet mes inflacionit dhe papunësisë.

Lëndë zgjedhore

- **Kontabiliteti menaxherial**

Lënda është dizajnuar për të pajisur studentët me njohuri në lidhje me konceptet bazike dhe t'i aftësojë për të aplikuar teknikat e kontabilitetit të menaxhimit për të kontribuar në suksesin e një firme. Kontabiliteti menaxherial ka evoluar nga regjistrimi dhe matja e kostove në funksion të mbështetjes së vendimmarrësve në vendimet e tyre të përditshme dhe strategjike. Për këtë arsye informatat jofinanciare janë përfshirë në raportet e kontabilitetit të menaxhimit. Këto informata përdoren në kombinim me informatat financiare për të ndërtuar një pasqyre që mund të kontribuojë që çdo ndarje, funksion, aktivitet, proces dhe procedura të jenë në funksion të arritjeve aktuale dhe strategjike të një firme.

- **Ekonomiksi i zhvillimit**

Qëllimet e lëndës janë: • Diskutimi i çështjeve kryesore që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik; • Përparimi i shkathtësive të studentëve për aplikim të modeleve ekonomike të ndërlidhura me problemet zhvillimore; • Rishikimi i literaturës empirike të fokusuar drejt formimit të rekomandimeve politike;

- **Matematika ekonomike**

Qëllimi i programit të lëndës: Njohja bazike e koncepteve matematikore është esenciale për t'i kuptuar pothuajse të gjitha konceptet e tjera në të gjitha fushat e ekonomisë. Matematika në përgjithësi, para së gjithash modelet matematikore janë esenciale për sqarimin dhe shprehjen e ideve kryesore ekonomike. Qëllimi i kësaj lënde është që t'i ndihmojë studentët për ta kuptojnë dhe ta shfrytëzojnë matematikën si mjet i pashmangshëm për studimin e ekonomisë dhe të menaxhimit. Konceptet matematikore që do të mësohen në këtë lëndë, paralelisht do të ilustrohen edhe me zbatimet përkatëse në lëmin e ekonomisë. Qëllimi është të përkufizohen konceptet bazike të modelimit linear, vargjet numerike dhe zbatimi i tyre, njehsimi i interesit dhe i huasë, si dhe aftësimi i studentëve për sjelljen e vendimeve. Po ashtu qëllimi është që të shfrytëzohen modelet matematikore në teorinë e optimizimit sikurse që është optimizimi i funksionit të harxhimit dhe të fitimit, etj.

- **Ekonomiksi menaxherial**

Qëllimet e programit të lëndës: - T'u mundësojë studentëve t'u qasen problemeve menaxheriale vendimmarrëse duke përdorur mendimin ekonomik; - Të paraqesin tema të praktikave të biznesit duke përdorur një qasje analitike, duke përdorur ekuacione dhe qasje numerike;

- **Menaxhimi i zhvillimit**

Qëllimi i lëndës është përdorimi i qasjes institucionale për studimin e procesit të zhvillimit dhe analizës së rrënjëve të përvojave zhvillimore dhe jozhvillimore në vendet, rajonet dhe organizatat e ndryshme. Qasja trajton teoritë institucionale të shkencave politikave, sociologjisë dhe ekonomisë së re institucionale. Qëllimet e lëndës janë: • T'i shpjegojë institucionet dhe organizatat nga aspekti teorik • T'i analizojë implikimet zhvillimore të formave të ndryshme organizative • Studimi i koordinimit në një ambient të rritjes në vazhdimësi të kompleksitetit të sistemeve institucionale, të cilat janë karakteristike për shtetet e zhvilluara • Të analizojë se si karakteristikat e kësaj ndërvarësie komplekse janë të ndërlidhura me vazhdimësinë e zhvillimit në shkallë të lartë dhe të ulët.

- **Metodat hulumtuese shoqërore**

Qëllimet e programit të lëndës: • t'i përshkruajë komponentët kryesorë të hulumtimit shoqëror; • të zhvillojë shkathtësi dhe dije për hulumtim shoqëror sasior dhe cilësor; • t'i identifikojë kriteret e përdorura për vlerësimin e cilësisë së hulumtimit shoqëror.

- **Sjellja konsumatore**

Qëllimet e programit të lëndës janë që studentët: - Të përfitojnë një kornizë për të analizuar probleme të sjelljes së konsumatorëve; - Të përfitojnë njohuri rreth zbatimit të këtyre teorive me problemet e konsumatorëve në jetë reale; - Të mësojnë se si sjellja e konsumatorit mund të ndikohet nga strategjitë e ndryshme të marketingut; - Të mësojnë mjete analitike (p.sh., vëzhgimin, matjet e identitetit dhe segmentimit, eksperimentimin laboratorik) që mund të përdoret për të hetuar sjelljen e konsumatorëve dhe të udhëheqë vendimmarrjen menaxheriale; - Të tregojnë se sa evidenca nga sjellja mund të përdoret për të vlerësuar strategjitë alternative të marketingut - T'i prezantojnë njohuritë aktuale të teorisë dhe praktikës në sjelljen e konsumatorëve bazuar në të njohurit e vetes për identitetin, identifikimin, si dhe kërkimet sociale e të vetë- konceptit; - T'i zhvillojnë aftësitë e tyre për të zbatuar konceptet e sjelljes së konsumatorëve për problemet e marketingut që ka të ngjarë të përfshijnë konsumit të konsumatorit si identifikimin e implikime të mundshme; - Ta zhvillojnë një kuptim më të thellë të sjelljes së konsumatorëve;

- **Menaxhimi i portofolit**

Lënda është dizajnuar të ofrojë një kuptim bazë të formave më të larta të organizimit ekonomik të tregjeve financiare, pra të tregjeve kapitale dhe parasë. Kujdes të veçantë i kushtohet numrit të madh të letrave me vlerë që aktualisht nuk janë të pranishme në Republikën e Maqedonisë, si dhe logjikës së fitimit kur zgjidhen letrat me vlerë për një portofol optimal investues. Kryesisht analizohet në hollësi momenti i riskut dhe kthimit potencial si dhe format e mbrojtjes, respektivisht mbrojtja kundrejt lëvizjeve të mundshme që ndodhin në kundërshtim me ato të priturat. Studentët pas mbarimit të këtij kursi do të jenë në gjendje të bëjnë letra me vlerë, të bëjnë mbrojtje dhe të dizajnojnë struktura komplekse të letrave me vlerë profitabile, ta njohin lehtësisht riskun dhe ta vlerësojnë vlerën relative të llojeve të veçanta të letrave me vlerë, etj.

- **Menaxhimi i projekteve**

Lënda u dedikohet studentëve të cilët janë të interesuar të fitojnë njohuri për menaxhim të projekteve në sferën e afarizmit dhe të asaj shoqërore e që paraqet një sfidë për të tashmen dhe të ardhmen. Lënda ofron një kornizë të konsiderueshme teorike në drejtim të krijimit të njohurive dhe shkathtësive të reja në sferën e projekteve si dhe menaxhimin efikas dhe efektiv të tyre. Studentët nga kjo lëndë do të arrijnë ta rrisin bindjen dhe besimin në vetvete si dhe do ta rrisin motivin kah përfitimi i njohurive dhe praktikave të reja. Qëllimet specifike të kësaj lënde janë: • Të kuptuarit e nivelit të kompleksitetit të projekteve bashkëkohore; • Krijimin e sistemeve strategjike adekuate për menaxhim me projektet; • Analizimi i rolit të menaxherit të kompanisë në drejtim të strukturimit të aktiviteteve për menaxhim të suksesshëm të projekteve; • Krijimi i buxhetit adekuat të projektit; • Të studiuarit e metodave dhe teknikave bashkëkohore për menaxhim me projektet, etj.

- **E-tregtia**

Qëllimet e lëndës së studimit janë: 1. Të mësohen konceptet themelore dhe terminologjia e e-tregëtisë (e-commerce) - historia e e-tregëtisë - e-bota: e-biznesi dhe e-tregtia - modelet e biznesit për e-tregtinë - sistemet e pagesave online - marketingu online - e-Infrastrukturat, etj. 2. Të mësohen teknologjitë kryesore të cilat janë të detyrueshme për të drejtuar e-tregtinë në ditët e sotme, duke përfshirë: shërbyesit (serverët), aplikacionet (software), lidhjet e internetit, portat e pagesës dhe sigurinë e tyre, "cookies", etj. 3. Aplikimi i konceptit "e-commerce" nga teoria në praktikë duke bërë analizë të duhur në modelet e biznesit dhe teknologjive si dhe marrjen e vendimeve në zgjidhjet më të përshtatshme. 4. Kuptimi i procesit të krijimit të një dyqani Ueb dhe lidhja e tij me sistemet e pagesës (porta pagese /

payment gateway). 5. Studenti të jetë në gjendje për të vënë këtë ide të e-biznesit në letër, të krijojë modelin e biznesit dhe të përgatisë financat. 6. Studenti të jetë në gjendje të dallojë mjetet e ndryshme në internet për marketing dhe të jetë në gjendje të zbatojnë disa prej tyre në praktikë. 7. Shqyrtimi mbi sigurinë e informacionit, etika dhe çështjet sociale si dhe mënyrat për të trajtuar çështje të veçanta. 8. Studenti të jetë i njohur me internet dhe "cloud" shërbimet.

- **Biznesi i vogël dhe sipërmarrësia**

Qëllimi i kësaj lënde është t'u ndihmojë studentëve ta kuptojnë këtë biznes dhe thelbin e ndërmarrjeve të vogla ndërmarrëse, funksionimin dhe organizimin e ndërmarrjeve të vogla ndërmarrëse në ekonomi dhe menaxhimin e tyre të suksesshëm gjatë procesit të zhvillimit.

- **Dizajni dhe menaxhimi i produktit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i përgatisë studentët që të përdorin metoda dhe teknika për dizajnim dhe menaxhim të produkteve dhe shërbimeve, ta bëjnë menaxhimin e tyre si dhe të jenë të aftë që këto produkte dhe shërbime t'ua ofrojnë kompanive biznesore.

- **Financat ndërkombëtare**

Qëllimet e lëndës janë që të ofrojë një hyrje në menaxhimin financiar ndërkombëtar dhe të diskutohet se pse është e rëndësishme të studiohen financat ndërkombëtare, dhe njëkohësisht të bëhet dallimi midis financave ndërkombëtare prej atyre vendore. Po ashtu paraqet dhe llojet e ndryshme të sistemeve monetare ndërkombëtare, sipas të cilave ekonomia botërore ka funksionuar dhe do të funksionojë në kohëra të ndryshme. Përveç kësaj, është prezantuar hollësisht diskutimi i Unionit Monetar Ndërkombëtar, konceptet e bilancit të pagesës dhe kontabiliteti. Lënda gjithashtu ofron një pasqyrë të qeverisjes korporative rreth strukturës qeverisëse të korporatave botërore, si ndryshojnë ato në masë të madhe në të gjitha vendet, duke reflektuar mjedise të ndryshme kulturore, ekonomike, politike dhe ligjore.

- **Ekonomiksi ndërkombëtar**

Qëllimet e lëndës janë që studentët të jenë të informuar dhe të jenë në gjendje që të përdorin të njëjtën njohuri dhe informacion që do t'u ndihmojë që të rrisin aftësitë e tyre për analiza kritike. Kjo lëndë duhet që t'i zgjerojë kapacitetet për arsyetimin abstrakt dhe t'u ndihmojë studentëve që t'i aplikojnë konceptet e tyre abstrakte në një realitet praktik të jetës moderne ekonomike.

- **Strategjia**

Kjo lëndë ka të bëjë me të menduarit strategjik. Ajo studion situatat në të cilat dy ose më tepër vendimmarrës bashkëveprojnë në mënyrë strategjike. Kuptimi i situatave strategjike përfshin konfliktin dhe/ose bashkëpunimin që është dëshmuar si shumë e dobishme në shumë fusha të ekonomisë, biznesit, politikës, shkencës, ligjit dhe psikologjisë shoqërore. Nga kjo lëndë pritet që t'u ndihmojë studentëve që të kuptojnë bazën e strategjive biznesore gjë që ofron mundësinë e përmirësimit të të menduarit strategjik në situata ku ekziston një ndërveprim.

- **Të folurit publik**

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me procesin e komunikimit, përgjegjësitë etike të të folurit publik dhe llojet e ndryshme të fjalimeve informative dhe bindëse. Përveç kësaj, studentët do të fitojnë njohuri të nevojshme për përgatitjen dhe dhënien e lojeve të ndryshme të fjalimeve, aftësi për ta analizuar publikun, të gjurmojnë tema për fjalime, të përgatisin fjalime, e të tjera. Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike duke qenë vetëkritikë konstruktivë dhe gjithashtu kritikë ndaj fjalime të kolegëve.

- **Debat dhe shkathtësi prezantimi**

Nga kjo lëndë studentët: - do të përfitojnë shkathtësi për diskutim dhe argumentim efektiv si dhe do të zhvillojnë vetëbesim për të folur para publikut; - do të përpilojnë, do të zhvillojnë dhe do të ushtrojnë prezantimin e argumenteve në mënyra të ndryshme përfshirë punën individuale, në çifte dhe prezantime në grupe; - do të mësojnë të përdorin retorikë bindëse, me qëllim të gjetjes së argumenteve që mbështesin një pozitë të caktuar lidhur me temat aktuale; - ndjekja e kësaj lënde do t'u mundësojë të njihen në mënyrë më të hollësishme me proceset e debatit formal, gjegjësisht me stilin parlamentar britanik për debate;

- **Studime ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e

ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të kursit Studime ndërkulturore studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Aftësitë e komunikimit**

Lënda është dizajnuar t'u mundësojë studentëve që praktikisht ta zbatojnë komunikimin ndërpersonal. Studentët do të mësojnë aftësi ndërpersonale siç janë: perceptimi, të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe ai jo verbal; do ta ushtrojnë të folurit publik, si për shembull: organizimin, prezantimin dhe bazat e të shkuarit fjalime publike. Studentët do të kenë mundësinë të praktikojnë komunikimin në grupe të vogla, duke filluar nga: lidhësi, vetëbesimi dhe të dëgjuarit. Kursi po ashtu ofron njohuri themelore të nevojshme për ta kuptuar procesin e kërkimit të një vendi pune nëpërmjet komunikimit me shkrim dhe me gojë, duke shkruar rezume, letër motivimi dhe duke simuluar intervista.

- **Excel i avancuar**

Qëllimi i lëndës është që t'i informojë studentët me aplikacionin Microsoft Excel dhe duke shfrytëzuar mundësitë që ofron ky aplikacion të jenë në gjendje të kryejnë detyra të avancuara të cilat janë ngushtë të lidhura me programin fakultativ të tyre.

- **Aftësi të avancuara të TI-së**

Qëllimet e lëndës janë: - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore dhe aftësi në fushën e shkencave informative dhe t'i njoftojë studentët me mundësitë që ato i ofrojnë; - T'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike rreth aplikacioneve të Microsoft Office (Windows, Word, PowerPoint, Excel, Access) dhe t'ju mundësojë që këto aplikacione edhe t'i aplikojnë në jetën e përditshme; - T'u mundësojë studentëve të punojnë projekte praktike individuale ose në grupe.

- **Word-i i avancuar**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i pajisë studentët me aftësi të avancuara rreth përdorimit të Word-it dhe PowerPoint-it. Ky kurs gjithashtu u mundëson studentëve që në mënyrë të pavarur të zbatojnë projekte të ndryshme si dhe detyra të veçanta komplekse të cilët janë të lidhura me programin e studimeve të tyre.

- **Google Apps**

Qëllimet e lëndës janë: - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri dhe aftësi të avancuara në fushën e shërbimeve elektronike (cloud applications); - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri teorike dhe praktike rreth Google Docs (G-mail, dokumente, spreadsheets, prezantime, vizatime dhe formulare) dhe t'i aplikojnë ato në jetën e tyre; - T'u mundësojë studentëve të punojnë individualisht ose në grupe në projekte të ndryshme drejtpërdrejt nga web browser-i.

- **Access-i i avancuar**

Bazat e të dhënave (databases) janë mjete ideale për ndjekjen e vëllimeve të mëdha. Microsoft Access-i është një mjet mjaft i fuqishëm dhe i popullarizuar i cili përdoret për hartimin dhe zhvillimin e Windows-based databases. Ky kurs është i dizajnuar për përdorues të rinj të Access-it ku janë të përpunuara funksionet e nevojshme për të punuar me bazat e të dhënave.

- **Desktop publikimi**

Qëllimi i kësaj lënde është hartimi dhe përpunimi i grafikave raster dhe vektor përmes programeve kryesore të Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe hartimi dhe botimi i materialeve komerciale për shtyp duke përdorur Adobe InDesign.

- **Ueb publikimi**

Zhvillimi i një ueb faqeje qoftë edhe e thjeshtë në përputhje me standardet aktuale kërkon njohuri të gjuhës së Hypertext Markup (XHTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumë faqe ueb përdorin imazhe qoftë në formë të banerëve, sustave, logove, fotografive apo skenimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e destinuar për ueb dhe për t'iu mundësuar krijuesve që t'i përdorin këto imazhe për të zvogëluar madhësinë e fajllit. Fireworks gjithashtu ofron një integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo seri ofron një hyrje të plotë në XHTML, CSS dhe krijimin e grafikës për ueb.

- **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat

drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë paraparë që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuha shqipe për qëllime profesionale**

Pas përfundimit të kursit Gjuha shqipe për qëllime profesionale, studentët do të jenë në gjendje praktikisht t'i përdorin njohuritë e fituara që do t'u shërbejnë në punësimin e tyre dhe gjatë karrierës në të ardhmen. Nga studentët pritet që ta dallojnë gjuhën e folur dhe të shkruar, karakteristikat e komunikimit profesional (raport, CV, e-mail), specifikat e shkrimit formal, format më të zakonshme gramatikore, ta bëjnë dallimin në mes stilit të të shkruarit shkencor, administrativ dhe socio-politik. Studentët do t'i mësojnë rregullat se si të organizojnë intervista dhe debate, të dinë se si të shkruajnë një letër motivimi dhe të interpretojnë tekste të veçanta në formë të shkruar dhe të folur.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjesë të shkruar do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimitdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën maqedone**

Pas mbarimit të kësaj lënde, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të përshtatshme dhe komunikim të avancuar në gjuhën maqedonase me theks të veçantë në aftësitë e të shkruarit. Pos kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm. Për më tepër, studentët do të jenë në gjendje t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të të shkruarit në më shumë nivele dhe në këtë mënyrë do të bëhen më të sigurt dhe më kompetentë gjatë të shkruarit në gjuhën maqedonase. Studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime. Studentët, gjithashtu, do të zhvillojnë aftësi për shkrim dhe komunikim të shkëlqyer në gjuhën maqedonase.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën shqipe**

Në fund të çdo niveli studentët do të jenë në gjendje të shkruajnë ese dhe punime kërkimore bazuar në rregullat e mësuara gjatë ligjëratave. Më konkretisht, nga studentët pritet që t'i mësojnë funksionin, strukturën dhe llojet e ndryshme të paragrafëve, mënyrat se si të zgjedhin tema për punime kërkimore, si të grumbullojnë materiale, rregullat se si t'i dokumentojnë referencat e të arrijnë deri tek modeli përfundimtar.

- **Gjuha gjermane (niveli 1-4)**

Pas përfundimit të çdo niveli nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimit të gjuhës. Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

- **Mbrojta e ambientit**

Qëllimet e lëndës janë: - T'i njoftojë studentët me problemet kryesore të mjedisit; - T'i njoftojë studentët me rolin e njeriut si faktor kyç në procesin e ndotjes dhe mbrojtjes së ambientit; - T'i njoftojë studentët me ndikimin e ndotësve të ndryshëm të ambientit në shëndetin e njeriut, veprimtarinë profesionale dhe aftësitë organizuese të faktorit njerëzor; - Krijimi i shprehive pozitive ndaj ambientit dhe ngritja e vetëdijes për një mjedis më të shëndetshëm dhe më të pastër; - Legjisllacioni ndërkombëtar dhe kombëtar dhe konventat ndërkombëtare mbi mjedisin; - Hyrje në politikat globale kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit; - Mjedi si një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; - Roli i shoqërisë në mbrojtjen e mjedisit; - Njoftimi me rreziqet kryesore për një mjedis të shëndetshëm; - Njoftimi me Strategjinë kombëtare të mjedisit në Republikën e Maqedonisë. Цели на предметната програма се студентите да стекнат знаења за: - основните проблеми на животната средина; - улогата на човекот како клучен фактор во процесот на загадувањето и заштита на животната средина; - влијанието на разните загадувачи на животната средина врз здравјето, професионалната активност и врз организациската способност на факторот човек; - создавањето позитивни навики за животната средина како и за подигањето

на свеста за потребите за поздрава и почистa средина; - меѓународната и националната легислатива како и меѓународните конвенции за животната средина; - за меѓународните и националните глобални политики во сферата на животната средина; - животната средина како услов за одржлив економски развој; - улогата на општеството во процесот на заштита на животната средина; - за главните ризици на здравата животna средина; - за Националната стратегија за животната средина на Р. Македонија. The aims of this course are: - To familiarize the students with the basic environmental problems; - To familiarize the students with the role of humans as the key factor in the process of pollution and environmental protection; - To familiarize the students with the influence of various environmental pollutants on health, the professional activity and the organizational ability of the human factor; - Creating positive habits for the environment and raising the awareness for a healthier and cleaner environment; - International and national legislation and international conventions on the environment; - Introduction to international and national global policies in the field of environment; - The environment as a condition for sustainable economic development; - The role of the society in the protection of the environment; - Introducing the major risks to a healthy environment; - Introducing the National Environmental Strategy of the Republic of Macedonia.

• **Zhvillimi profesional i karrierës**

Kjo lëndë ofron mësim praktik të orientuar drejt rezultateve për kërkim. Po ashtu lënda i aftëson di ta fitojnë dhe si ta mbajnë vendin e punës. Ka për qëllim që studentëve t'u sigurojë aftësi të përshtatshme për vende pune moderne. Detyrë kryesore do të jetë përpilimi i CV, shkrimi i letrës së interesit/kërkesës, aftësitë për të intervistuar, komunikimi zyrtar në zyrë (memorandume, e-maile oficiale për mbikëqyresit, konsumatorët, raporte e të tjerë). Elemente shtesë që do t'i përfshijë kjo lëndë janë: si të bëhet vetëvlerësimi, si të menaxhohet konflikti midis dy zyrave dhe si të kërkohet në mënyrë aktive promovimi. Aftësitë e fituara në këtë lëndë do të jene të zbatueshme edhe në procesin e kërkimit të punës në përgjithësi.

• **Sistemet e informacionit dhe organizatat**

Qëllimet e lëndës: 1. Të mësohen konceptet themelore dhe terminologjia e Sistemeve të Informacionit: a. Sistemet themelore të Informacionit dhe konceptet: harduer, softuer, rrjete; b. E-World: e-biznesi dhe e-tregëtia; c. Proceset zhvilluese; 2. Të mësohet më shumë në lidhje me sistemet e informacionit dhe teknologjitë që i përmirësojnë vlerat e biznesit dhe proceset e ndryshme brenda organizatave; 3. Të aplikohen IS konceptet në disiplina të ndryshme të menaxhmentit, gjatë analizës, interpretimit, vlerësimit dhe vendimeve; 4. Të kuptohet procesi i ridizajnit të organizatave duke përdorur sistemet e informacionit; 5. Të përshkruhet roli i sistemeve të informacionit në vendimmarrje; 6. Të shqyrtohet siguria e informacionit, si dhe çështjet etike dhe çështjet sociale; 7. Të bëhet njoftimi me internetin, tregtinë elektronike dhe e-biznesin; 8. Të përgatiten studentët për të punuar në projekte të vogla me anë të punës individuale apo grupe, të cilët nga natyra mund të ndahen në këto kategori: studime të rastit, projekte kërkimore-shkencore, projektet zhvillimi të një sistemi apo projekte praktike;

• **E drejta afariste dhe organizatat**

Në kuadër të lëndës "E drejta afariste e organizatave" studentët njihen me institutet themelore, siç janë: tregtari, tregtari individual dhe shoqëritë tregtare, themelimi i shoqërive tregtare, format e shoqërive tregtare, përfaqësimi i shoqërive tregtare; përfaqësuesi tregtar dhe tregtari udhëtar, sekreti afarist, regjistri tregtar dhe procedura për regjistrim, librat tregtare, llogaritë vjetore dhe raportet financiare, ndryshimet statusore të shoqërive tregtare, shuarja e shoqërive tregtare.

• **Komunikimi afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me konceptin e komunikimit afarist. Në vitet e fundit shumë kompani aplikojnë teknikat e komunikimit të biznesit si një mjet kryesor në përgjigje të konkurrencës së lartë në tregun global. Kjo lëndë paraqet një përpyetje për të përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me teori, por mbi të gjitha nëpërmjet praktikës të mësojnë komunikimin e drejtë me të punësuarit dhe menaxherët në një mjedis organizativ, si dhe gjatë mbajtjes së takimeve, intervistimit e të tjerëve se si të përgjigjen në intervistë, negociimin si dhe motivimin e të gjithëve përreth tyre.

• **Demokracia dhe demokratizimi**

Qëllimi i lëndës: Studentët me anë të kësaj lënde do të fitojnë shkathtësi, dije dhe qasje në: • Kuptimin e proceseve, teorive dhe analizave empirike që kanë të bëjnë me institucionet politike dhe sjelljen politike; • Aftësi për implementimin e procesit të mendimit kritik, aplikimin e metodave të hulumtimit dhe analizë kuantitative; • Kompetenca të shkrimit dhe komunikimit akademik;

• **Shteti dhe politika demokratike**

Qëllimi i lëndës: • Studentët do të demonstrojnë njohuri dhe kuptim për proceset politike në demokracitë liberale moderne; Studentët në mënyrë kritike do t'i analizojnë premiset e demokracisë liberale; • Studentët do të fitojnë shkathhtësi dhe njohuri adekuate t'i zbatojnë konceptet më të rëndësishme teorike dhe modelet në analizë të institucioneve kyçe të shtetit bashkëkohor dhe në mënyrë kritike t'i vlerësojnë teoritë e shtetit;

- **Distribuími dhe metodat e shitjes**

Qëllimet e lëndës: • Prezantimi i elementeve të tregut dhe institucioneve të tij nga aspekti i ndikimit të tij në bërjen e qarkullimit; • Njohjen e faktorëve të cilët kanë ndikim mbi zhvillimin e tregtisë; • Njohjen e bartësve të veprimtarisë tregtare; • Njohja e çështjeve lidhur me shpenzimet, marzhën - rabatin dhe krijimin e çmimeve në shitjen me pakicë; • Krijimi dhe udhëheqja e politikave tregtare;

- **Zhvillimi i karrierës**

Lënda është e krijuar ta nxisë procesin e planifikimit të hershëm dhe zhvillimit të karrierës. Ky proces përfshin vetanalizën e thellë, hulumtimin e planifikimit të karrierës dhe monitorimin e strategjive paraprake të punësimit, etj. Filozofia e lëndës është se ky proces është i vazhdueshëm, sistematik dhe synon jetën në vendin e punës si një pjesë e një plani të kompletuar të zhvillimit personal. Angazhimi në këtë proces duhet të jetë sfidues, interesant dhe të ofrojë kënaqësi. Shijimi i përfitimeve të ofertës së kësaj lënde, ndihmon në tranzicion nga student në të punësuar dhe do t'ju ndihmojë në përmbushjen e planeve në rrugën më të drejtpërdrejt në qëllimet afatgjate të karrierës përmes parashikimit dhe të mësuarit të aftësive të nevojshme, kurse dhe përvojë pune, për të cilat hyrja do të jetë pika më e mirë fillestare për karrierën që pretendoni.